



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LIGJ

Nr. 102/2018

**PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 55/2015 “PËR INVESTIMET STRATEGJIKE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë” bëhen shtesat si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 13 bëhen këto shtesa:

a) Në pikën 1, pas shkronjës “e” shtohet shkronja “ë” me këtë përmbajtje:

“ë) vërtetim mbi gjendjen gjyqësore ose një dokument, të lëshuar nga një autoritet kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë kushtet e parashikuara në pikën 1/1, të këtij neni.”.

b) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Subjekti përjashtohet nga përfitimi i statusit “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar”, apo “Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë”, nëse është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e veprës penale:

a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste;

b) korrupsion;

c) mashtrim;

ç) pastrim parash ose financim i terrorizmit;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste;

dh) organizim, drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, si dhe i veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;

e) falsifikim;

ë) shfrytëzim i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.

Përfashtimi nga shqyrtimi, miratimi dhe mbështetja e investimeve strategjike zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i një subjekti investues, aksionar ose ortak i tij, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij.”.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 13.12.2018